



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.Nr.220/2021

Datë: 28 korrik 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Jashar Gashi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Klinë, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/06/2021/GJTHPE-AD-GJTHPE.nr.5/21, të datës 1 korrik 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 28 korrik 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Jashar Gashi**, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Klinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.
2. Për këtë shkelje disiplinore Gjyqtarit Jashar Gashi i shqiptohet sanksion disiplinor **vërejtje publike me shkrim**.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.121/2021, i datës 30 prill 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduara të Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë-dega në Klinë Jashar Gashi. Sipas pretendimit të Autoritet Kompetent Gjyqtari Jashar Gashi në rastin e procedimit të lëndës penale P.nr.296/2012, e cila është udhëhequr sipas aktakuzës PP/II.nr.1416.2015, të datës 16 shtator 2016, ka treguar neglizhencë në trajtim të çështjes brenda afateve të arsyeshme dhe mungesë të vullnetit të tij që kjo lëndë të procedohet me kohë. I njëjti sipas Autoritetit Kompetent, duke e ditur se bëhet fjalë për lëndë të vjetra dhe se afati i parashkrimit është i shkurtër, për rreth dy vite nuk kishte ndërmarr asnjë veprim, respektivisht ka ndërmarr një veprim ndërsa veprimin tjetër e kishte ndërmarr pas një viti.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore, KGJK ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor Gjyqtari Valon Kurtaj dhe subjekti i hetimit disiplinor Gjyqtari Jashar Gashi.

Kryesuesi i panelit hetimor në fjalën hyrës dhe përfundimtare, ka deklaruar se mbështet raportin ku jepen faktet dhe provat e mbledhura duke ja lënë Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të vendos se në rastin konkret disiplinor nese ekziston apo nuk ekziston shkelje disiplinore nga Gjyqtari Jashar Gashi.

Gjyqtari Jashar Gashi, në seancën dëgjimore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka deklaruar se lëndën kontestuese e ka pranuar më datë 2 tetor 2017, dhe më datë 2 tetor 2018 ka nxjerr aktvendim P.nr.296/2017, më të cilën e ka shpallur veten jokomptent në bazë lëndore dhe e ka dërguar lëndën në kompetencë në Departamentin e Përgjithshëm për Krime të Renda në Pejë. Me datë 29 tetor 2018, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë i'a kishte kthyer Gjyqtarit Gashi në rivendosje lëndën kontestuese. Me datë 14 tetor 2019, Gjyqtari Gashi kishte mbajtur shqyrtimin fillestar, ndërsa me datë 20 nëntor 2019, kishte nxjerr Aktvendimin P.nr.296/17, me të cilin kishte hedhur poshtë aktin akuzues. Më tutje, Gjyqtari Gashi ka cekur se arsyeje se pse ka ardhur deri te kjo vonës qe ka shkaktuar parashkrimin absolut të lëndës penale P.nr.296/2012, ka qenë edhe ngarkesa e madhe me lëndë, përafërsisht me 300-400 lëndë dhe se nuk ka pasur asnjë qellim tjetër. Ai ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ta liroj nga përgjegjësia disiplinore.

Për ta vërtetuar këtë çështje KGJK administroi dhe vlerësoi këto prova: Aktakuza PPII.nr.1416/2015, e parashtruar ndaj te akuzuarit _____ për veprën penale trajtim i pandërgjegjshmen mjekësor nga neni 260 paragrafi 1 te KPRK; Kërkesën për përjashtim nga çështia penale sipas Aktakuza PPII.nr.1416/2015; Kërkesa e parashtruar nga Gjyqtari _____

Aktvendimi GJ.A.nr.610/2017, më të cilin Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, e ka aprovuar kërkesën për përjashtim të Gjyqtarit _____ Gjyqtari Jashar Gashi, Aktvendim P.nr.296/2017, me te cilin e shpall veten jo kompetent në baza lëndore dhe i dërgon lëndën në kompetence Departamentit të Krimeve të Renda ne Peje: Shkresa nen numrin P.nr.296/2017, me të cilën Gjyqtari Jashar Gashi e dorëzon fizikisht lëndën në Pejë; Shkresën P.nr.76/18, me të cilën Kryetari i Gjykatës - _____ i drejtohet Prokurorisë Themelore në Pejë, me kërkesë për ta shqyrtuar aktin akuzues se ne rastin konkret a kemi te bëjë me vepër penale ne kompetencë të Departamentit të Krimeve të Renda, apo Departamentit të Përgjithshmen; Shkresa PP-Nr-141/2015, Prokuroria Themelore në Pejë, Kryeprokurori _____ ia kthen lëndën Gjykatës Themelore në Pejë, me konstatimin se prokuroria qëndron pranë të njëjtit cilësinë juridik të veprës penale dhe konsideron se lënda duhet te trajtohet nga Departamenti Përgjithshmen; Shkresa PP/II.nr.1416/2015, Prokurore Sanije Gashi Seferi, ia kthen Gjykatës Themelore në Pejë, të gjitha shkresat e lëndës dhe mendimin e Kryeprokurorit _____ Shkresën P.nr.76/18, të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë ia kthen shkresat e lëndës Degës në Klinë, respektivisht Gjyqtarit Jashar Gashi, për në rivendosje të me tejme; Procesverbal i datës 14 tetor 2019, i shqyrtimit fillestar; Kërkesën për hedhjen e aktit akuzues nga mbrojtësi i të akuzuarit Shkelzen Elezaj; Procesverbalin e datës 20 nëntor 2019, i shqyrtimit te dyte: Aktvendimin P.nr.296/17, me të cilin është hedhur akti akuzues; Ankesën e parashtruar nga Prokuroria Themelore në Pejë: Aktvendimi PN.nr.1411/2019, ku Gjykata Apelit, aprovon ankesën e prokurorisë dhe çështjen e kthen ne gjykim në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega ne Kline; Shkresa e datës 13 mars 2020, Gjykata Apelit, me këtë shkresë e ka dorëzuar lëndën në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Kline; Raportin mbi pranimin e lëndëve nga _____ po ashtu edhe te lëndës kontestuese; Aktvendimin P.nr.296/2017, me te cilin Gjyqtarja _____ e ka hedhur aktin akuzues për shkak te parashkrimit absolut të ndjekjes penale; Me datë 26 nëntor 2020, Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e të dëmtuarit dhe ka lenë në fuqi vendimin për hedhjen e aktit akuzues për shkak te parashkrimit absolut të ndjekjes penale; ankesa për inicimin e hetimit disiplinor pranë Autoritetit Kompetent (Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë e parashtruar nga i dëmtuari _____ përmes Avokat _____

Përgjigje e Gjyqtarit Jashar Gashi, me shkrim dhëne ne ankesën disiplinore, ku ketë përgjigje ia ka drejtuar Kryetarit të Gjykatës, sipas kërkesës se tij; Përgjigjen e Gjyqtares me shkrim ka dhëne përgjigje në ankesën disiplinore, ku ketë përgjigje ia ka drejtuar Kryetarit të Gjykatës, sipas kërkesës se tij.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK konstatoi se Gjyqtari Gashi, Aktvendim P.nr.296/17, mbi kompetencën e gjykatës e kishte marrë një (1) vit pas pranimit të lëndës. Sipas vlerësimit të KGJK-së gjyqtari ka dështuar ta trajtoj në një afat të arsyeshëm çështjen në fjalë, prandaj veprimet e gjyqtarit për inkomptencë një vit pas pranimit të dosjes kualifikohet si neglizhencë dhe pakujdesi duke marrë parasysh se lënda ka qenë lëndë e vjetër dhe është dashur të tregohet kujdes i shtuar.

Me tutje, sipas të gjeturave të KGJK-së Gjyqtari Gashi ishte vonuar edhe kur lëndën penale P.nr.296/2017 Gjykata Themelore në Pejë, me datë 29 tetor 2018 ja kishte kthyer në rivendosje, ndërsa gjyqtari kishte caktuar shqyrtimin fillestar me datë 14 tetor 2019, pas 11 muaj e 15 ditë nga dita e pranimit të lëndës për herë të dytë. Sipas vlerësimit të KGJK-së, Gjyqtari Gashi me këtë zvarritje të procedimit të lëndës kontestuese, ka sjell deri të parashkrimi absolut i lëndës kontestuese.

KGJK, vlerëson se sjelljet e Gjyqtarit Jashar Gashi në rastin konkret janë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve .

KGJK i shqyrtoi me kujdes masat disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vlerësoi se në rastin e Gjyqtarit Jashar Gashi, sanksioni disiplinor **vërejtje publike me shkrim** është sanksion disiplinor proporcional në raport në shkeljen e bërë të gjyqtarit, dhe se e njëjta do të shërbej si mase për disiplinimin e gjyqtarit dhe si preventivë për të ardhmen. Si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të këtij sanksioni disiplinor KGJK mori parasysh edhe ngarkesën e madhe më lëndë.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, dhe paragrafi 2, pika 2.1, 2.4, dhe 2.5, të Ligjit nr.06/l-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.220/2021, datë: 28 korrik 2021

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 15 ditëve pas pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Armend Berisha, Kryetar, Gjykata Themelore ne Pejë;*
- *Jashar Gashi, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë-dega në Klinë;*
- *Arkivit të KGJK-së;*